



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-2128/24
Kaçanik, 23.01.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja I (parë) e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 23 janar 2024 (E martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 13:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi-OJQ.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e I-të (parë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2024, data 23 janar, me këtë :

REND PUNE

- 1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
- 2.Diskutim për hartimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024;
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete,

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?

Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverballi ?

Procesverballi i mbledhjes së X-të (dhjetë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2023, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverballin e mbledhjes së X-të (dhjetë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2023, të datës 26.12.2023 / Lënda : 01Nr. 60/03-32649/23.

2. Diskutim për hartimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024;

z.Ekrem Livoreka: Hapi diskutimin lidhur me planin e punës së Komitetit për komunitete, nëse keni ndonjë propozim.

z.Arben Thaqi: Lidhur me pikën 2-të propozojë që "Strategjia e përmbushjes së planit të Komitetit për Komunitete", të largohet nga plani i punës së Komitetit për Komunitete dhe të futet një pikë tjetër konkretisht "Gjendja e furnizimit me energji elektrike në komunën e Kaçanikut", të hy si aktivitet Vizitë në zyrën e furnizimit me energji elektrike në komunën e Kaçanikut, Furnizim jo i rregullt me energji elektrike. Tarifat e larta të energjisë elektrike, Ndërprerja e rrymës elektrike për shkak të punimeve në rrjetë.

znj.Arta Avdiu: Pajtohem me propozimet që u cekën më lartë nga z. Arben Thaqit.

z.Ekrem Livoreka: Pajtohem me propozimet e bëra nga z.Arben Thaqit, lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e aktiviteteve në planin e punës së Komitetit për Komunitete, specifikisht përfshirjen e pikave si "Gjendja e furnizimit me energji elektrike në komunën e Kaçanikut".

znj.Lejla Muhaxheri-Çaka: Gjithashtu edhe unë pajtohem me propozimet e z.Arben Thaqit.

z.Ekrem Livoreka: Vazhdojmë sipas radhës me pikët e planit të punës së Komitetit për Komunitete.

z.Ekrem Livoreka: Pika 3-të, "Gjendja e Arsimit në komunën e Kaçanikut" - mbetet në plan të punës.

Pika 4-të, "Të drejtat e qytetarëve të komunës së Kaçanikut - mbetet në plan të punës.

z.Arben Thaqi: Pika 5, "Ndarja e garantëve dhe subvencioneve për OJQ"- mbetet në plan të punës. Pika 6, "Rastet sociale në komunë e Kaçanikut - mbetet në plan të punës.

znj.Arta Avdiu: Tek pika e 7-të, "Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut", të hy si aktivitet vizitë në Gjykatën Komunale në komunën e Kaçanikut. Në pikën 8 të planit "Gjendja aktuale e QKMF-së në komunën e Kaçanikut", të hy si aktivitet vizita me drejtorin e QKMF-së, me qëllim që të informohemi rreth furnizimit me barna esenciale si dhe procesin e vaksinimit dhe Ndërgjegjësimi për kancerin e gjirit .

znj.Lejla Muhaxheri-Çaka: Pika 9-të, "Gjendja e bizneseve në komunën e Kaçanikut" - mbetet në plan të punës .

z.Ekrem Livoreka: Pika 10-të, “ OVL e UÇK-së në komunën e Kaçanikut ” - mbetet në plan të punës.

A jeni të pajtimit që ky plan i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024, ti përcillet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim?

Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024 , u shtrua në votim dhe i njëjti u votua njëzëri. Me këtë konstatojmë që:

Plani i Punës së Komitetit për Komunitete, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3.Të ndryshme:

z.Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 14:15.

Procesmbajtës
Mavije Murseli



Kryesues i Komitetit
Ekrem Livoreka

